



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.09.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtim i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes se financimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosove 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Marrin pjese:

Ermonela Felaj, Sadi Vorpsi, Eljo Hysko, Luan Duzha, Antoneta Dhima, Xhemal Qefalia, Lefter Maliqi, Luan Harusha, Anduel Xhindi, Elena Xhina dhe Adnor Shameti.

Mungojnë:

Alban Zeneli, Edmond Rrushi, Paulin Sterkaj, Ylli Shehu, Arben Elezi dhe Myslim Murrizi.

Të ftuar :

Etjen Xhafaj – Zëvendësministër në Ministrinë e Jashtme

Elkada Himci - Drejtorja e Fondeve te BE-se në Ministrinë e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj- Mirëdita, kolegë!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

Sot në rendin e ditës kemi parashikuar miratimin e procesverbalit të datë 09.09.2019 dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”. Relator për këtë projektligj do të jetë z.Eljo Hysko.

Fillojmë së pari me miratimin e procesverbalit. Kush është dakord Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Për të paraqitur projektligjin sot kemi të ftuar z. Etjen Xhafaj, Zëvendësministër në Ministrinë e Jashtme dhe znj.Elkada Himci, përfaqësuese nga Drejtoria e Fondeve të BE-se në Ministrinë e Jashtme.

Po z.Xhafaj, fjala për ju.

Etjen Xhafaj – Faleminderit zonja kryetare.

Të nderuar deputetë!

Projektligji që sjellim sot, ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2017.

Marrëveshja e financimit është miratuar, në parim, nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet vendimit nr.568, datë 3.10.2018. Kjo marrëveshje financimi u nënshkrua për palën shqiptare nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, në datën 23.10.2018, dhe nga pala kosovare në datën 31.12.2018.

Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 840 000 euro, për të dyja vendet.

Nënvizojmë se, në total, kontributi që do të japë BE-ja për zbatimin e përbashkët të programit Shqipëri-Kosovë, për periudhën 2014-2020, arrin vlerën 8 400 000 euro, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare ndërmjet vendit tonë, Kosovës dhe Komisionit Evropian. Sjellim në vëmendje se ndërmjet këtyre palëve janë bërë tri marrëveshje të tjera financimi për të njëjtin program (për alokimet e viteve 2014 dhe 2015 dhe alokimet e vitit 2016), të cilat janë miratuar me vendimet e Këshillit të Ministrave nr.908, datë 11.11.2015, nr.249, datë 29.3.2017, dhe nr.536, datë 19.9.2018.

Përfitues të këtij programi janë zonat, si më poshtë:

Në Shqipëri: Qarku i Lezhës, Qarku i Kukësit;

Në Kosovë: Rajoni Ekonomik Perëndimor dhe Rajoni Ekonomik Jugor

Ermonela Felaj- Flm Zoti. Xhafaj.Dëgjojmë edhe relatorin z.Hysko

Eljo Hysko – Faleminderit Znj.Kryetare për fjalë. Faleminderit edhe zëvendësministrit për paraqitjen e projektligjit.

Qëllimi i këtij projektligji është ratifikimi i marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri – Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri - Kosovë ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis dy vendeve, nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta. Ky program mbështet, gjithashtu, shkëmbimin e eksperiencës dhe të njohurive ndërmjet përfituesve si dhe përmirësimin e politikave publike ndërmjet autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike: Mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rreziqeve;

Inkurajimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore e natyrore;

Investimi në rini, arsim dhe aftësi;

Përfitues të këtij programi janë:

Në Shqipëri: Qarku i Lezhës, Qarku i Kukësit;

Në Kosovë: Rajoni Ekonomik Perëndimor dhe Rajoni Ekonomik Jugor

Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i BE-së, nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 840 000 euro, për të dyja vendet.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen, ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, sipas prioritetëve të përcaktuar në program, duke u mundësuar, në këtë mënyrë, aktorëve rajonalë dhe vendorë, nga të dyja vendet, të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme dhe një efekt të matshëm për sektorin social-ekonomik.

Nisur nga sa me sipër, ftoj anëtarët e këtij komisioni ta miratojmë projektligjin në parim, nën për nën dhe në tërësi.

Ermonela Felaj- Faleminderit z.Hysko për fjalën tua. Kalojmë në pyetjet. Ka pyetje kolegë? Nuk ka. Diskutime? Nuk ka.

Dakord. Faleminderit!

Në mund të kalojmë në miratimin në parim të projektligjit!

Kush është dakord me miratimin në parim të projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit nëpërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”? Kundër dhe abstenim nuk ka. Faleminderit!

Kalojmë në miratimin nën për nën të projektit.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2?

A ka ndonjë ndërhyrje nga kolegët? Nuk ka.

Kush është dakord me këtë nen?

Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi?

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim. Nuk ka.

Miratohet.

Mirë atëhere kolege. Ka diçka për të thënë z.Qefalia.

Xhemal Qefalia - Duke përfutur nga prezenca e komisionit, do të shpreh një shqetësim, që e kam ndjekur dhe në medie, të Presidentit të Republikës, i cili solli në vëmendjen e Komisionit Hetimor, por edhe të opinionit publik, një informacion për djegien e Kuvendit nga persona të veçantë.

Bashkë me kolegun Vorpsi, mbështetur në nenin 8 për statusin e deputetit, ku çdo deputet ka të drejtë të kërkojë shpjegime, kemi përgatitur një shkresë drejtuar kryetarit të Shërbimit Informativ, për të na informuar rreth këtij informacioni që disponon Presidenti.

Në të njëjtën kohë, ftoj komisionin të dakordësohet, që kryetari i Shërbimit Informativ të vijë dhe të na informojë rreth deklaratës së bërë dje në Komisionin Hetimor nga Presidenti Republikës.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Zoti Shameti, urdhëroni!

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke qenë se unë jam edhe anëtar i Komisionit të posaçëm Hetimor për veprimtarinë e Presidentit të Republikës, me gjithë respektin dhe vlerësimin që kam për kolegun e nderuar, e kam quajtur shumë të drejtë shqetësimin që ai ngre në Komisionin e Sigurisë, por do të thosha se, duke qenë se ka një komision të posaçëm hetimor të ngritur për këtë çështje, nuk dua të ketë mbivendosje të ushtrimit të kompetencave apo të të drejtave nga Komisioni i Sigurisë te Komisioni i posaçëm Hetimor.

Në përfundim të veprimtarisë së Komisionit Hetimor, nëse do të ngelet diçka e paezauruar, mund ta ushtroni këtë të drejtë. Unë do të rekomandoja të mos kemi mbivendosje të veprimtarisë së punës së Komisionit të Sigurisë me atë të Komisionit të posaçëm Hetimor. Ju siguroj se të gjitha shqetësimet dhe problemet do të gjejnë mbështetje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Alban Zeneli – Meqenëse edhe unë jam anëtar i Komisionit Hetimor, do të doja të shtoja se jam dakord me zotin Shameti, që të mos ketë mbivendosje. Më vonë, pas raportit...

Ermonela Felaj – Po, Zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – I falënderoj të dy kolegët!

Të jeni të bindur se nuk do t'i marrim kompetencat e Komisionit Hetimor, i cili mund të vazhdojë të ushtrojë funksionin e tij. Unë bashkë me kolegun Vorpsi, do të vazhdojmë të ushtrojmë të drejtën tonë, në bazë të statusit të deputetit, për t'i kërkuar informacion kryetarit të Shërbimit Informativ.

Unë e ftova, që të ishte me interes edhe për ju, si anëtarë, por Komisioni Hetimor nuk ka lidhje me Komisionin e Sigurisë. Unë jam anëtar i Komisionit të Sigurisë Kombëtare dhe jam i shqetësuar, besoj se duhet të jeni edhe ju, që informacione të tilla qarkullojnë për persona të veçantë, madje aludohet që janë të identifikuar. Jam i interesuar të di se çfarë po bëhet me ta.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zonja kryetare!

Pavarësisht se çfarë do të vendoset me kërkesën e dy deputetëve, dua të sqaroj se nga ana ligjore nuk kemi asnjë mbivendosje. Me sa kuptoj, kërkesa e zotit Qefalia nuk ka lidhje me veprimtarinë e Presidentit të Republikës, por me një informacion që ka dalë nga një mbledhje, që është bërë publike në medie, dhe është tagër i çdo deputeti, aq më tepër i një deputeti të Komisionit të Sigurisë, për të kërkuar informacion.

Për më tepër, është në tagrin e çdo deputet ta çmojë ose jo si kërkesë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit për ndërhyrjet tuaja!

Ndërkohë, më lejoni t'ju vë në dukje nenin 36 të Rregullores së Kuvendit, i cili parashikon se në rast se duam të organizojmë seanca të veçanta dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore, siç u kërkuar në rastin në fjalë, komisioni është i detyruar ta realizojë seancën dëgjimore vetëm në rast se 1/3-a e të gjithë anëtarëve e kërkojnë këtë gjë në mënyrë të motivuar dhe me shkrim. Nëse do të kemi një kërkesë të tillë, në atë moment do të diskutojmë dhe do të marrim një vendim.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rregullorja më detyron të kem kërkesë me shkrim, të cilën nuk e kam, nga 1/3-a e anëtarëve të komisionit.

Përveç kësaj, ne e kishim miratuar rendin e ditës kur u diskutua kjo gjë, por, gjithsesi, nuk kemi një kërkesë me shkrim nga ana e 1/3-ës së komisionit, që të marrim një vendim dhe të jemi të detyruar të bëjmë seancë dëgjimore.

Nesër do të kemi sërish mbledhje të komisionit parlamentar për projektligjin për ndryshimet klimatike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ditën e premte do të kemi një mbledhje me anëtarët e Nënkomisionit të Vetingut.

Ju rikujtoj orën 12:00.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA